

Festa e shkollave 2022
3P dhe 4P
E mërkurë, 29 qershor pasdite

INFORMACIONE PËR PRINDËRIT E KLASAVE 3P, 4P DHE SHKOLLIMIT TË DYFISHTË 2P/3P

Përpara festës

Gjatë qershorit, ju do të merrni në çantën e nxënësit, një fletëpalosje me informacione për festën *(për t'u shkarkuar në fund të faqes)*.

Në këtë fletëpalosje, mësuesi/-ja/--it ka shënuar orën në të cilën ju duhet të dorëzoni fëmijën/-ët tuaj në shkollë. Lutemi të jeni të përpiktë, sepse autobusët duhet të nisen në kohë drejt vendit të festës.

Piktogram « Vini re »

Fëmijët nuk duhet të sillen direkt në parkun e Bastions ose në nisjen e kortezhit. Ata priten pranë shkollës së tyre.

Dita e festës

Kortezhi

Ju mund të jeni të pranishëm në kortezh gjatë gjithë rrugëtimit, por, për çështje organizimi dhe sigurie, Shëtitorja St-Antoine, pika e nisjes së kortezhit, nuk është e hapur për publikun dhe as për familjet.

Rreth 3300 fëmijë marrin pjesë në kortezh. Gjithashtu, ju lutemi të respektoni udhëzimet.

Ju mund të ndiqni, në mënyrë të drejtpërdrejtë, kortezhin dhe Festën e shkollave në parkun e Bastionit në Televizionin Léman Bleu. Ky reportazh do të ritransmetohet gjithashtu në vazhdimësi gjatë gjithë verës.

Itinerari i kortezhit – Nisja në orën 14:30

Promenade Saint-Antoine → Rue des Chaudronniers → Place du Bourg-de-Four → Rue Verdaine → Rue de Rive → Rue de la Croix-d'Or → Rue du Marché → Rue de la Confédération → Rue de la Corraterie → Place de-Neuve

Piktogram i motit

Në rast dyshimi për motin, ju mund të telefononi në numrin 1600, më 29 qershor prej orës 12:00.

Nëse moti është i pasigurt, festa në park do të zhvillohet, por kortezhi anulohet.

Transportet publike do të sjellin fëmijët, sipas parashikimeve, por do t'i dorëzojnë drejtpërdrejt në parkun e Bastions.

Nëse moti është i keq, kortezhi dhe festa në park anulohen.

Nxënësit dhe mësuesit do të vinë drejtpërdrejt në shkollën e tyre (nëse nuk janë tashmë në vend) në orën 13:30. Nxënësit lirohen në orën 16:00.

Parku i Bastions

Lutemi e jani të kërkoni fëmijën/-ët tuaj në parkun e Bastions në orën 17:30, ora e hapjes së dyerve për publikun. Me qëllim lehtësimin e hyrjes në park, lutemi të respektoni udhëzimet e mëposhtme

- **Shkollat që i përkasin grupeve 1 dhe 2 > lutemi kaloni nga hyrja e dyerve nga ana e rrugës Saint-Léger**
- **Shkollat që i përkasin grupeve 3 dhe 4 > lutemi kaloni nga hyrja e dyerve nga ana e Place de Neuve**

plani i grupeve në park shkarkohet në fund të faqes

Këtë vit, festa dhe karuselet do të përfundojnë në orën 17:30.

Hyrja në parkun e Bastions

Tramvajet 12, 18 – Stacioni Place de Neuve

Autobusët 3, 5, 36 – Stacioni Place de Neuve

Informacione shtesë

Shërbimi i shkollave dhe institucioneve për fëmijë

022.418.48.00

Ecoles@ville-ge.ch